



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 20943 Prot

Tiranë, më 14.9 .2018

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

Për publikim: Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Ligjit 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe VKM-së 921 datë 29.12.2014, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

- **Komandant grupi** në Sektorin Operativ Antitrafik, në Drejtorinë e Antitrafikut, Kategoria C1, Kategoria e pagës III-b (2 vende)

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare;
2. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
3. Të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
4. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
5. Të zotërojnë diplomë të nivelit të Lartë "Master Profesional" në Shkencat Ekonomike, Juridike, Natyrore, të lidhura me Sigurinë dhe Hetimin, Akademi Ushtarake/Policore;
6. Të kenë njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit;
7. Të ketë eksperiencë pune të paktën 1 (një) vit;
8. Të ketë njohuri të gjera të fushës, të metodave kërimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre;

9. Njohja e gjuhës angleze (gjuhë e dytë avantazh);
10. Pajisja me Certifikatë Sigurie nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar përbën avantazh.

Përshkrim përgjithsues për pozicionin:

1. Administron dhe drejton Grupin përkatës Operativ Antitrafik nëpërmjet drejtimit, kontrollit, këshillimit, udhëzimit dhe zgjidhjes së problemeve.
2. Bashkëpunon dhe koordinon me struktura të tjera të Departamentit Operativo-Hetimor, për të përmbushur përgjegjësitë e Drejtorisë Antitrafik.
3. Kryen detyra administrative dhe pune teknike, përfshi këtu dhe planifikimin, organizimin, mbikqyrjen dhe menaxhimin e të gjitha aspekteve të punës në Grupin përkatës Operativ Antitrafik.
4. Kryen veprimtari teknike dhe administrative për të evidentuar e plotësuar në mënyrë periodike të dhënat statistikore për drejtimit e punës që mbulon duke zhvilluar dhe analiza për tendencat e trafikut të paligjshëm për mallrat e ndaluara dhe kufizuara.
5. Merr pjesë në operacione të përbashkëta me grupe të tjera si dhe me Policinë e Shtetit dhe organe të tjera të specializuara, të miratuara nga Drejtoria Antitrafik.
6. Bën rekomandime për iniciativa dhe ndryshime në përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve.
7. Evidenton dhe përcakton shkakun e problemeve, formulon dhe paraqet rekomandime për përmirësimin e proceseve dhe praktikave të përcaktuara.
8. Përgatit informon për eprorin mbikqyrës në fund të çdo shërbimi për ecurinë në punë, siguron përmbylljen, saktësimin në kohë të të gjitha funksioneve operative.
9. Planifikon mënyrën e organizimit të Grupit gjatë kryerjes së detyrës.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim;
2. Curriculum Vitae (dhe letër motivimi);
3. Diplomë dhe Listë Notash të noterizuar;
4. Dëshmi Penaliteti (do të vihet në dispozicion nga Drejtoria e MBNJ pas plotësimit të formularit të vetdeklarimit);
5. Vërtetim nga Gjykata;
6. Vërtetim nga Prokuroria;
7. Raport mjeko-ligjor;
8. Fotokopje karte identiteti;
9. Fotokopje të librezës së punës;
10. Fotokopje të kurseve kualifikuese;
11. Letër referencë dhënë nga punëdhënësi/eprori direkt i pozicionit të fundit.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e përzgjedhjes bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale dhe me intervistë. Kandidatët që marrin mbi 50 pikë në vlerësimin e dosjes konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në vlerësimin e përvojës, në kualifikimin dhe aftësitë e kandidatit.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 21.09.2018, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Belinda Ikonimi

